



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA



Me 07.07.2023
Mamushë

Nr. i referencës: 626-23-011-5-2-1

Në bazë të nenit 62 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 43 paragrafi 43.7 pika (a) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-5588-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-011-5-2-1

II

I njëjti duhet të rishpallet sipas procedurave të prokurimit, pas afatit për ankesa.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 05.06.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: **NDËRTIMI I GARAZHËS PËR AUTOAMBULANCAT NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-s NË MAMUSHË** me nr. të prokurimit: 626-23-5588-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-22-011-5-2-1. Pas njoftimit për kontratë dosjen e tenderit e kanë shkarkuar tridhjetedy (32) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar vetëm tre (3) prej tyre.

Dispozitat e legjislacionit të prokurimit kanë paraparë që në rastet kur pas hapjes së tenderit, vërtetohet se të gjithë operatorët ekonomik të përgjegjshëm, kanë dorëzuar tender të cilët përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-s, mund të anulohet procedura e prokurimit në fjalë.

Komisioni vlerësues pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të procedurës në fjalë ka konstatuar që të gjithë operatorët e përgjegjshëm pjesëmarrës në këtë tender kanë dorëzuar tender të cilët përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-s

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.7 pika (a) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

